

V E N D I M
Nr.307, datë 24.5.1994

PËR SHËRBIMET E PËRKUJDESJES SHOQËRORE

Në zbatim të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, me propozimin e ministrit të Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

A. Shërbimet e përkujdesjes shoqërore

1. Shërbimet e përkujdesjes shoqërore përfshijnë:

- a) shërbimet jashtë institucionit;
 - b) shërbimet në institucion.
- 2. Shërbimet jashtë institucioneve përfshijnë:**
- a) qendra ditore (për handikapatët, fëmijë të rrugës, të moshuar etj.)
 - b) shërbimet në shtëpi;
 - c) ndihmat emergjente.

Lloje të tjera të shërbimeve mund të sigurohen jashtë institucioneve. Këto shërbime nuk financohen nga buxheti i shtetit.

3. Shërbimet në institucione sigurohen për:

- a) fëmijët jetimë dhe të braktisur;
- b) handikapatët (fizikë dhe mendorë, fëmijë dhe të rritur, të paaftë për t’u kujdesur për veten;
- c) personat e moshuar të vetmuar, në qoftë se janë të paaftë për t’u kujdesur për veten.

4. Ministria e Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale përgjigjet për:

- a) drejtimin dhe financimin e institucioneve dhe shërbimeve shoqërore;
- b) autorizimin dhe koordinimin e shërbimeve shoqërore të pushtetit lokal;
- c) autorizimin e organizatave joqeveritare dhe personave privatë që krijojnë dhe që mbajnë institucionet dhe shërbimet e përkujdesjes shoqërore;
- ç) autorizimin e personave për drejtimin e institucioneve të përkujdesjes shoqërore;
- d) marrjen e raportimeve dhe inspektimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore;
- dh) paraqitjen çdo vit në Këshillin e Ministrave të një raporti për ecurinë e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore.

B. Shërbimet dhe drejtimi në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

5. Shërbimet e përkujdesjes shoqërore sigurohen nga pushteti qendror, pushteti lokal (komunat dhe bashkitë), organizatat joqeveritare dhe nga persona privatë.

6. Shërbimet jashtë institucioneve sigurohen nga pushteti lokal. Organi kompetent për këto shërbime është këshilli i bashkisë ose komunës. Këta këshilla mund të kenë nën vartësi edhe institucionet që sigurojnë këto shërbime vetëm me autorizim të Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale.

7. Shërbimet në institucione sigurohen nga pushteti qendror. Ministria e Punës, Emigracionit dhe e Përkrahjes Sociale është i vetmi organ kompetent për këto shërbime.

8. Shërbimet dhe institucionet e përkujdesjes shoqërore organizohen si:

- a) pjesë e administrimit publik (organizata buxhetore);
- b) person juridik.

Çdo shërbim a institucion i përkujdesjes shoqërore paraqet statutin sipas shtesës 1 që miratohet nga Ministria e Punës, Emigracionit dhe e Përkrahjes Sociale.

Institucionet e organizuara si person juridik duhet të jenë pa qëllim fitimi. Gjithë shtetasit përfitojnë nga këto institucione, nëse përmbushin kushtet e parashikuara në statut.

9. Pushteti lokal ose ai qendror mund të lidhin kontratë sipas shtesës 2 me organizatat joqeveritare ose personat privatë që i kryejnë këto shërbime. Kontrata mund të lidhet për një periudhë deri në 10 vjet.

10. Shërbimet e përkujdesjes shoqërore, brenda dhe jashtë institucionit, kryhen vetëm me autorizim të Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet e miratuara nga kjo ministri.

11. Shërbimet brenda dhe jashtë institucionit mund të drejtohen vetëm nga personat që kanë autorizimin e ministrit të Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, i cili lëshohet në bazë të kërkesës me shkrim të personave që kanë kualifikimin dhe përvojën e duhur profesionale, si dhe janë me banim në Shqipëri.

C. Financimi i shpenzimeve të shërbimeve shoqërore.

12. Shpenzimet për shërbime jashtë institucioneve miratohen nga këshilli lokal dhe përfshihen në buxhetin e këtij këshilli.

13. Buxheti i institucioneve që sigurojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore, miratohet nga Ministria e Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale.

14. Kontratat e nënshkruara për mbështetjen e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore nga organizata joqeveritare dhe persona privatë, të cilët përfshijnë pjesëmarrjen e buxhetit të shtetit, kërkojnë miratimin dhe zbatimin e rregullave të buxhetit të shtetit, të përcaktuara nga Ministria e Financave. Buxheti në këto raste i nënshtrohet procedurave të përcaktuara në pikat 12 dhe 13 të këtij vendimi.

15. Të ardhurat që sigurohen nga pjesëmarrja financiare e klinetëve, pasqyrohen veçmas në buxhetin e këtyre shërbimeve dhe derdhen në buxhetin e shtetit.

15.1. Të ardhurat që sigurohen nga veprimtaritë e ndryshme të klinetëve të organizuara pranë institucioneve të përkujdesjes shoqërore, pasqyrohen veçmas në buxhetin e tyre dhe përdoren nga këto subjekte së bashku me të ardhura të tjera, siç janë donacionet.

Ç. Raportimi dhe inspektimi i shërbimeve shoqërore

16. Për shërbimet në institucione ose jashtë tyre (lokale), private a publike, raportohet çdo vit periodikisht në Ministrinë e Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale. Procedura e raportimit përcaktohet nga kjo ministri. Në rastin e financimit publik në raport përfshihen edhe të ardhurat e shpenzimet, sipas strukturave të përcaktuara nga buxheti i shtetit.

17. Inspektimi i shërbimeve shoqërore kryhet nga:

- Ministria e Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, për sa i përket të drejtave të njeriut dhe zbatimit të legjislacionit, si edhe përdorimit të mjeteve të buxhetit të shtetit.

- Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit në lidhje me normat higjienike.

- Ministria e Arsimit për arsimin e detyrueshën.

- Ministria e Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ministria e Arsimit përgatitin aktet nënligjore për kryerjen e inspektimit.

18. Në rastet e nxjerrjes së pengesave në kryerjen e inspektimit dhe pakujdesive në raportim, personat përgjegjës ndëshkohen me masa disiplinore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përsëritja e këtyre shkeljeve mund të jetë shkak për zgjidhjen e kontratës ose anulimin e autorizimit nga Ministria e Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale.

Ministria e Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale merr të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e të drejtave të klientëve të këtyre shërbimeve shoqërore.

D. Masa tranzitore

19. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit transferon në Ministrinë e Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, institucionet e mëposhtme:

- Institucioni për fëmijë me të meta mendore në Tiranë

- “ “ “ “ “ Durrës

- “ “ “ “ “ Shkodër

- “ “ “ “ “ Berat

- “ “ “ “ “ Korçë

20. Ministria e Arsimit transferon në Ministrinë e Punës, brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, institucionet e mëposhtme:

- Shtëpi të fëmijës parashkollore (3-6 vjeç) Shkodër

- “ “ “ “ Vlorë

- “ “ “ “ (6-14 vjeç) Shkodër

- “ “ “ “ Tiranë

- “ “ “ “ Sarandë

21. Këto institucione transferohen së bashku me ndërtesën, pajisjet, inventari dhe personelin.

22. Të gjitha kontratat e lidhura me organizatat joqeveritare nga organet përkatëse shtetërore

para hyrjes në fuqi të këtij vendimi rishqyrtohen dhe zëvendësohen me kontrata të reja me Ministrinë e Punës, Emigracionit e Përkrahjes Sociale, brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
Me lidhjen e kontratës së re kontrata e vjetër shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi